

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme/ NATO rrëzon një dron në Lituani
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/rusia-dhe-ukraina-shkembejne-e-nato-rrezon-nje-dron-ne-lituani-i474185
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 06:39:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	44973dea550d00b5f8be11984387bf5a74c56e88968a6c8ac994dcb18e9d9698
TEKSTI	f0d349b8d8c891b19f69440c5d25a022fb3a5f5468250e9fb6825c2de776f12e
PAMJA	1df6f16fdc0f6d27d40071aa9e993a8322ee1a2936707f4d127547af6fa0c95d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2d41ee151e84a2335d68d06216c1b81541ecd492c36c4c8d7f6ec0380099e8c3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2d41ee151e84a2335d68d06216c1b81541ecd492c36c4c8d7f6ec0380099e8c3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Rusia dhe Ukraina shkëmbejnë sulme/ NATO rrëzon një dron në Lituani



15 Shtator 2026, 08:20, Kosova & Bota CNA



Rusia dhe Ukraina kanë shkëmbyer sulme gjatë natës duke goditur një pikë karburanti dhe një rafineri naftë, sipas autoriteteve vendëse dhe kanaleve vëzhguese në Telegram.

Këto sulme ndodhën vetëm disa orë pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha të hënën mbrëma se Moska dhe Kiev i ishin pajtuar të mos i sulmonin objektet energjetike të njëri-tjetrit.

Ndërkohë, autoritetet lituaneze thanë se një avion luftarak i NATO-s e rrëzoi një dron që hyri në hapësirën ajrore të vendit në orët e para të së martës.

Në kryeqytetin ukrainas, një pikë karburanti dhe disa objekte magazinimi u goditën të martën herët dhe një burrë u shtrua në spital në gjendje të rëndë pas sulmit, tha kryetari i Kievit, Vitali Klitschko.

Rusia i ka zgjeruar sulmet së fundmi edhe ndaj pikave të karburantit në Kiev, ndërsa autoritetet ukrainase thonë se rreth 300 pika karburanti janë goditur muajt e fundit, shumica e tyre në ose pranë rajoneve të vijës së frontit.

Ndërkohë, një sulm me raketa në qytetin rus Taganrog, pranë kufirit me Ukrainën, dëmtoi një magazinë në pronësi të shitësit online Ozon, si dhe magazina që u përkasin kompanive bujqësore, tha të martën guvernatori rajonal, Yuri Slyusar.

Rajoni i Samarës në Rusi u vu gjithashtu në shënjestër të dronëve gjatë natës, ndërsa një objekt industrial pësoi dëme, sipas guvernatorit rajonal, Vyacheslav Fedorishchev, i cili shtoi se 40 dronë u shkatërruan gjatë sulmit.

Ai nuk tregoi se për cilin objekt bëhej fjalë. Ky rajon është shtëpi e një numri rafinerish të mëdha të naftës.

Kanalet vëzhguese në Telegram raportuan se pas një sulmi me dronë, në zonën industriale të rafinerisë së naftës në Syzran, në rajonin e Samarës, u pa një zjarr.

Sulmet ndodhën pak pasi Trump tha në një postim në Truth Social të hënën se: "Ukraina është pahtuar për të mos i goditur caqet energjetike ruse. Rusia është pajtuar për të njëjtën gjë!"

Pas postimit të Trumpit, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Kyevi ishte i gatshëm t'i ndalte sulmet ndaj Rusisë nëse aleatët e Ukrainës do të garantonin se Moska do t'i ndalte sulmet ndaj objekteve energjetike, infrastrukturës kritike dhe rrugëve të furnizimit me ushqime në Ukrainë.

Avioni i NATO-s rrëzon dronin mbi Lituanë

Ndërkohë, në Lituanë, një avion luftarak i NATO-s e rrëzoi një dron të martën herët në mëngjes, tha Qendra Kombëtare Lituanëze për Menaxhimin e Krizave, pasi më herët ishte lëshuar një alarm për dronë në kryeqytet, Vilnius, dhe në rajonin përreth.

"Së bashku me aleatët e vet të NATO-s, Lituania do ta mbrojë hapësirën e vet ajrore", shkroi presidenti lituanëz, Gitanas Nausėda, në X pas incidentit.

Sipas transmetuesit publik lituanëz LRT, i cili iu referua të dhënave paraprake nga Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Krizave, droni kishte ardhur nga Bjellorusia fqinje dhe po lëvizte drejt perëndimit.

Incidenti në Lituanë, anëtare e BE-së dhe NATO-s, ndodhi pas sulmeve të fundit me dronë nga Rusia pranë kufirit me Poloninë.

Kievi ka paralajmëruar së fundi se Moska "po troket në derën e NATO-s".

"Sulmet barbare të Rusisë në kufirin Ukrainë-Poloni, në Yahodyn, nuk janë thjesht vazhdim i sulmeve të saj ndaj kufijve shtetërorë", shkroi në X të dielën ministri i Jashtëm ukrainas, Andriy Sybiha.

"Ky është terrori i Putinit që po 'troket' drejtpërdrejt në dyert e BE-së dhe NATO-s", shtoi ai. /REL





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

SHBA-të konfirmojnë për herë të parë se kanë vendosur armë në hapësirë

Hetimet për korrupsion/ Zelensky kërkon shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm të Ukrainës

Paralajmërimi se IA mund të shkatërrojë njerëzimin/ Trump: Është një mashtrim

Vuçiq: Do të jap dorëheqjen si president më 27 shtator

Marrëveshja e njoftuar nga Trump/ Zelensky: Dyshoj në gatishmërinë e Rusisë për ta zbatuar

U propozua nga LVV dhe LDK/ Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president

Mbyllet aeroporti i Katanias/ Shkak aktivizimi i vullkanit Etna

"Çmimi i naftës u rrit nga lufta e tyre, jo nga Irani"/ Trump njofton marrëveshjen mes Ukrainës dhe Rusisë

BE: I takon Kushtetueses ta gjykojë formimin e Qeverisë dhe të Kuvendit

Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht çfarë mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

"Një rol strategjik dhe më proaktiv"/ 12 vende i kërkojnë BE-së të forcojë praninë në Arktik

Kurti bën thirrje për bashkëpunim në zgjedhjen e presidentit të ri

Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Ruman

Zgjedhjet në Berlin mes radikalizimit të politikës

CDU fiton zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme

PDK-ja i kërkon Kushtetueses të vendosë masë të përkohshme për konstituimin e Kuvendit

Pas krizës në Ceuta/ BE, drejt ashpërsimit të politikave të emigracionit

Djegia e tragetit në Filipine/ Mund të duhen muaj për të identifikuar viktimat

Zgjedhjet në Suedi/ Blloku i krahut të majtë në avantazh

Rusia godet trenin ukrainas pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarët e lartë evropianë largohen nga stacioni

[editorial](#)

16:28 Editorial Elvi FUNDO

Edhe një herë për deputetin analfabet dhe "mbështetësit" e tij

CNA LIVESTREAM



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.